

**STABILIZIM ASOCIIMI MES BASHKIMIT
EVROPIAN DHE KOSOVËS***

**Bruksel, 28 korrik 2016
(OR. en)**

Këshilli i Stabilizim Asociimit

BE-KS 2001/16

AKTET LEGJISLATIVE DHE INSTRUMENTET E TJERA

Lënda: **VENDIMI I KËSHILLIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT BE-KOSOVË*** për
miratimin e rregullores së tij të punës

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

VENDIMI Nr. 1/2016

I KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-KOSOVË*

i [data]

për miratimin e rregullores së tij të punës

KËSHILLI I STABILIZIM-ASOCIIMIT,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian për Energji Atomike, në njërën anë, dhe Kosovës*, në anën tjetër (‘Marrëveshja’) dhe në veçanti nenet 126,127,129 dhe 131 të saj,

Duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të Marrëveshjes më 1 prill 2016,

MIRATON KËTË VENDIM:

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Neni 1

Kryesimi

Palët mbajnë kryesinë e Këshillit të Stabilizim-Asociimit me radhë, për një periudhë prej 12 muajsh. Periudha e parë fillon në datën e takimit të parë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 2

Takimet

Këshilli i Stabilizim-Asociimit mblidhet një herë në vit, në pajtim me praktikat e krijuara të Këshillave të Stabilizim-Asociimit, duke përfshirë nivelin e përfaqësimit edhe vendtakimet. Me kërkesë të cilësdo palë mund të mbahen takime të veçanta të Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nëse kështu dakordohen Palët. Takimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit do të thirren bashkërisht nga Sekretarët e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, pas dakordimit me Kryesuesin.

Neni 3

Delegacionet

Para çdo takimi Kryesuesi do të informohet me përbërjen paraprake të delegacionit të secilës Pale. Në takimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit merr pjesë edhe një përfaqësues i Bankës Evropiane për Investime (BEI), në cilësinë e vëzhguesit, kur në agjendë të takimit ka çështje me interes për BEI-në. Në takimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit mund të ftohen edhe përfaqësues të tjerë me qëllim që të ofrojnë informata të nevojshme për tema të caktuara.

Neni 4
Sekretariati

Një zyrtar i Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe një zyrtar i përfaqësisë së Kosovës në Belgjikë veprojnë bashkërisht si Sekretarë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Neni 5
Korrespondenca

Korrespondenca që i adresohet Këshillit të Stabilizim-Asociimit i dërgohet Kryesuesit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit në adresën e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian.

Të dy Sekretarët sigurohen që korrespondenca t’i përcillet Kryesuesit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe, sipas nevojës, t’u shpërndahet edhe anëtarëve të tjerë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit. Korrespondenca i dërgohet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komisionit, Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm dhe Përfaqësisë së Kosovës në Belgjikë.

Komunikimet nga Kryesuesi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit u dërgohen të adresuarve nga të dy Sekretarët dhe u shpërndahen, sipas nevojës, anëtarëve të tjerë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit të përmendur në paragrafin e dytë.

Neni 6
Publiciteti

Përveç nëse vendoset ndryshe, takimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit nuk do të jenë publike.

Neni 7
Agjendat e takimeve

1. Kryesuesi harton agjendën e përkohshme për çdo takim. E njëjta u përcillet nga Sekretarët e Këshillit të Stabilizim-Asociimit të adresuarve të përmendur në nenin 5 jo më vonë se 15 ditë para fillimit të takimit. Agjenda e përkohshme do të përmbajë pikat në lidhje me të cilat Kryesuesi ka pranuar kërkesën për përfshirjen në agjendë jo më vonë se 21 ditë para fillimit të takimit, ndonëse pikat nuk do të shkruhen në agjendën e përkohshme, përveç nëse dokumentacioni mbështetës u është dërguar Sekretarëve jo më vonë se në datën e shpërndarjes së agjendës. Agjenda miratohet nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit në fillim të çdo takimi. Në agjendë, me pajtimin e të dyja Palëve, mund të shtohet ndonjë pikë shtesë nga ato që janë në agjendën e përkohshme.

2. Kryesuesi, në pajtim me të dyja Palët, mund të shkurtojë afatet kohore të specifikuar në paragrafin 1, me qëllimin që të merren parasysh kërkesat për ndonjë çështje të caktuara.

Neni 8
Procesverbali

Draft-procesverbali i secilit takim hartohet nga të dy Sekretarët. Procesverbali, si rregull e përgjithshme, duhet të paraqesë lidhur me të gjitha pikat e agjendës, si në vijim:

- dokumentacionin e paraqitur para Këshillit të Stabilizim-Asociimit,
- deklaratat që kërkohen të përfshihen nga ndonjë anëtar i Këshillit të Stabilizim-Asociimit,
- vendimet e marra dhe rekomandimet e dhëna, deklaratat e dakorduara dhe konkluzionet e miratuara.

Draft-procesverbali i dërgohet Këshillit të Stabilizim-Asociimit për miratim. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi dhe të dy Sekretarët. Procesverbali arkivohet në arkivat e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian, e i cili do të shërbejë si arkivues i dokumenteve zyrtare të Asociimit. Një kopje e vërtetuar i dërgohet secilit të adresuar të përmendur në nenin 5.

Neni 9
Vendimet dhe rekomandimet

1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit merr vendime dhe nxjerr rekomandime me pajtimin e të dyja Palëve, pa paragjykuar nenin 2 dhe 5 të Marrëveshjes. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të marrë vendime ose të nxjerrë rekomandime me procedurë me shkrim, me pajtimin e Palëve.

2. Vendimet dhe rekomandimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, në kuadër të kuptimit të nenit 128 të Marrëveshjes, do të emërtohen “Vendim”, gjegjësisht “Rekomandim”, pasuar nga një numër rendor, data e miratimit të tyre dhe nga një përshkrim i çështjes tematike. Vendimet dhe rekomandimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit nënshkruhen nga Kryesuesi dhe vërtetohen nga të dy Sekretarët. Vendimet dhe rekomandimet i dërgohen secilit prej të të adresuarve të përmendur në nenin 5. Secila Palë mund të vendosë rreth publikimit të vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të Stabilizim-Asociimit në publikimet përkatëse zyrtare.

Neni 10
Gjuhët

Gjuhët zyrtare të Këshillit të Stabilizim-Asociimit janë gjuhët autentike të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Përveç nëse vendoset ndryshe, Këshilli i Stabilizim-Asociimit i bazon diskutimet e tij në dokumentet e hartuara në ato gjuhë.

Neni 11
Shpenzimet

Bashkimi Evropian dhe Kosova mbulojnë shpenzimet që bartin për pjesëmarrjen e tyre në takimet e Këshillit, si për sa i përket stafit, udhëtimit dhe shpenzimeve ditore, ashtu edhe sa u përket shpenzimeve postare dhe të telekomunikimit. Shpenzimet në lidhje me përkthimin në të folur në takime, përkthimin me shkrim dhe riprodhimin e dokumenteve, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me organizimin e takimeve, mbulohen nga Pala nikoqire e takimeve.

Neni 12
Komiteti i Stabilizim-Asociimit

1. Komiteti i Stabilizim-Asociimit ('Komiteti') themelohet, me qëllim që të ndihmojë Këshillin e Stabilizim-Asociimit në kryerjen e detyrave të veta. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të Bashkimit Evropian, në një të anë, dhe Kosovës, në anën tjetër, normalisht në nivel të shërbyesve të lartë civilë.

2. Komiteti përgatit takimet dhe diskutimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, zbaton vendimet e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, sipas nevojës, dhe në përgjithësi siguron vazhdimësinë e marrëdhënies së asociimit dhe funksionimin normal të Marrëveshjes. Ai shqyrton çfarëdo çështje që i adresohet nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit si dhe çfarëdo çështje tjetër që mund të dalë gjatë zbatimit të përditshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ai i parashtron Këshillit të Stabilizim-Asociimit propozime ose çfarëdo draft-vendimi/rekomandimi, për miratim.
3. Në rastet kur Marrëveshja i referohet ndonjë obligimi për t'u konsultuar, ose ndonjë mundësie për konsultime, këto konsultime mund të zhvillohen në kuadër të Komitetit. Konsultimet mund të vazhdojnë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, me pajtimin e Palëve.
4. Rregullorja e punës e Komitetit të Stabilizim-Asociimit është bashkëngjitur si Shtojcë e këtij Vendimi.

Nënshkruar në:

Për Këshillin e Stabilizim-Asociimit
Kryesuesi

SHTOJCË
e
VENDIMIT Nr. 1/2016
TË KËSHILLIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT BE-KOSOVË*

e [*data*]

Rregullorja e Punës e Komitetit të Stabilizim-Asociimit

Neni 1
Kryesimi

Palët mbajnë kryesimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit ('Komiteti') me radhë, për një periudhë prej 12 muajsh secila. Periudha e parë fillon në datën e takimit të parë të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 2
Takimet

Komiteti takohet sipas rrethanave, me pajtimin e të dy Palëve. Secili takim i Komitetit mbahet në kohën dhe vendin e dakorduar nga të dy Palët. Takimet e Komitetit thirren nga Kryesuesi.

Neni 3
Delegacionet

Para secilit takim, Kryesuesi informohet rreth përbërjes së paraparë të delegacionit të secilës Pale.

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Neni 4
Sekretariati

Një zyrtar i Komisionit Evropian dhe një zyrtar i Kosovës shërbejnë bashkërisht si Sekretarë të Komitetit. Të gjitha komunikimet me dhe nga Kryesuesi i Komitetit të parapara në këtë Vendim u përcillen Sekretarëve të Komitetit dhe Sekretarëve dhe Kryesuesit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Neni 5
Publiciteti

Përveç nëse vendoset ndryshe, takimet e Komitetit nuk do të jenë publike.

Neni 6
Agjendat e takimeve

1. Kryesuesi harton agjendën e përkohshme për çdo takim. Ajo u përcillet nga Sekretarët e Komitetit të adresuarve të përmendur në nenin 4 jo më vonë se 30 ditë para fillimit të takimit. Agjenda e përkohshme përmban pikat në lidhje me të cilat Kryesuesi ka pranuar kërkesën për përfshirje në agjendë jo më vonë se 35 ditë para fillimit të takimit, ndonëse pikat nuk duhet të shkruhen në agjendën e përkohshme, përveç nëse dokumentacioni mbështetës u është dërguar Sekretarëve jo më vonë se në ditën e shpërndarjes së agjendës. Komiteti mund të kërkojë nga ekspertët të marrin pjesë në takim me qëllim që të ofrojnë informata rreth temave të caktuara. Agjenda miratohet nga Komiteti në fillim të secilit takim. Në agjendë mund të shtohet ndonjë pikë shtesë përveç atyre të vendosura në agjendën e përkohshëm me pajtimin e të dyja Palëve.

2. Kryesuesi, në dakordim me të dyja Palët, mund të shkurtojë afatet kohore të specifikuara në paragrafin 1 për të marrë parasysh kërkesat për ndonjë çështje të caktuar.

Neni 7
Procesverbali

Procesverbali mbahet për secilin takim dhe bazohet në një përmbledhje, nga Kryesuesi, të konkluzioneve të arritura nga Komiteti. Pas miratimit nga Komiteti, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi dhe nga të dy Sekretarët dhe dorëzohet zyrtarisht nga secila Palë. Nga një kopje e procesverbalit i dërgohet secilit të adresuar të përmendur në nenin 4.

Neni 8
Vendimet dhe rekomandimet

Në raste të caktuara kur Komitetit i jepet kompetenca nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit, sipas nenit 128 të Marrëveshjes, për të marrë vendime dhe nxjerrë rekomandime, këto akte do të kryhen në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Punës së Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Neni 9
Shpenzimet

Bashkimi Evropian dhe Kosova mbulojnë secila shpenzimet e veta që dalin nga pjesëmarrja e tyre në takimet e Komitetit, si në lidhje me stafin, udhëtimet dhe shpenzimet ditore, ashtu edhe në lidhje me shpenzimet postare dhe ato të telekomunikimit. Shpenzimet në lidhje me përkthimin në të folur në takime, përkthimin me shkrim dhe riprodhimin e dokumenteve, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me organizimin e takimeve, mbulohen nga Pala nikoqire e takimeve.

Neni 10

Nënkomitetet dhe grupet e veçanta

Komiteti mund të themelojë nënkomitete dhe grupe të veçanta që punojnë nën autoritetin e tij. Ata i raportojnë Komitetit pas çdo takimi të tyre. Komiteti mund të vendosë të shpërbëjë cilindo nënkomitete ose grup ekzistues, të përcaktojë ose modifikojë termat e tyre të referencës ose të themelojë nënkomitete ose grupe të tjera për të ndihmuar Komitetin në kryerjen e detyrave të tij. Këto nënkomitete dhe grupe nuk do të kenë asnjë kompetencë vendimmarrëse.

SHTOJCA

DRAFT

VENDIMI Nr. 1/2016

I KOMITETIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-KOSOVË*

e [data muaji] 2016

për themelimin e nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta

KOMITETI I STABILIZIM-ASOCIIMIT,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian për Energji Atomike, në njërën anë, dhe Kosovës*, në anën tjetër, dhe në veçanti nenin 130 të saj,

Duke pasur parasysh rregulloren vet të punës, veçanërisht nenin 10 të saj,

MIRATON KËTË VENDIM:

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Neni i vetëm

Përmes kësaj themelohen nënkomitetet dhe grupet e veçanta të përmendura në Shtojcën I. Termat e referencës së tyre janë përcaktuar në Shtojcën II.

Në, më [data, muaji] 2016.

Për Komitetin e Stabilizim-Asociimit

Kryesuesi

SHTOJCA I

Struktura shumëdisiplinare e nënkomiteteve

Titulli	Çështjet	Neni i Marrëveshjes
1. Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet	Lëvizja e lirë e mallrave	Neni 20
	Produktet industriale	Nenet 21-25
	Çështjet tregtare	Nenet 36-49
	Standardizimi, metrologjia, akreditimi, certifikimi, vlerësimi i konformitetit, dhe mbikëqyrja e tregut	Neni 80
	Bashkëpunimi industrial	Neni 99
	NVM-të	Neni 100
	Turizmi	Neni 101
	Doganat	Neni 104
	Tatimet	Neni 105
	Rregullat e origjinës	Protokolli III
	Asistenca e ndërsjellë administrative në çështjet doganore	Protokolli IV
2. Bujqësia dhe peshkataria	Produktet bujqësore	Neni 26, 28, 29, 33, 34 dhe 37
	Produktet e peshkut	Neni 31 dhe 32, Shtojca IV dhe V
	Produktet e përpunuara bujqësore	Neni 27 dhe Protokolli I

Titulli	Çështjet	Neni i Marrëveshjes
	Verërat	Neni 30 dhe Protokolli II
	Mbrojtja e treguesve gjeografik për produktet bujqësore dhe të peshkatarisë dhe ushqimet e tjera përveç verërave dhe pijeve alkoolike	Neni 35
	Bujqësia dhe sektori agro-industrial, temat e veterinarisë dhe fitosanitarisë	Neni 102
	Bashkëpunimi në peshkatari	Neni 103
3. Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca	E drejta e themelimit	Nenet 50-54
	Ofrimi i shërbimeve	Nenet 55-60
	Çështjet e tjera të ndërlidhura me Titullin V të Marrëveshjes	Nenet 61-73
	Përafrimi i legjislacionit, dhe zbatimi i ligjit	Neni 74
	Konkurrenca	Nenet 75-76
	Pronësia intelektuale, industriale dhe komerciale	Nenet 77-78
	Prokurimi publik	Neni 79
	Bankat, sigurimet dhe shërbimet e tjera financiare	Neni 96
	Mbrojtja e konsumatorit	Neni 81
4. Çështjet ekonomike dhe financiare dhe statistikat	Pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit	Nenet 64-66
	Politikat ekonomike	Neni 94
	Bashkëpunimi statistikor	Neni 95
	Promovimi dhe mbrojtja e investimeve	Neni 98
	Bashkëpunimi financiar	Nenet 121-125

Titulli	Çështjet	Neni i Marrëveshjes
5. Drejtësia, Liria dhe Siguria	Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit	Neni 83
	Të drejtat themelore, përfshirë kundër-diskriminimin dhe mbrojtjen e të dhënave	Nenet 3, 4 dhe 84
	Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale	Neni 83
	Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi	Nenet 85-86
	Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm, ripranimi	Nenet 87-88
	Shpëlarja e parave	Neni 89
	Drogat	Neni 90
	Luftimi i terrorizmit	Neni 92
	Parandalimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera ilegale	Neni 91
6. Inovacioni, Shoqëria e Informacionit, dhe Politikat Sociale		
	Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta	Neni 82
	Bashkëpunimi social	Neni 106
	Arsimi dhe trajnimet	Neni 107
	Bashkëpunimi kulturor	Neni 108
	Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale	Neni 109

Titulli	Çështjet	Neni i Marrëveshjes
	Shoqëria e informacionit	Neni 110
	Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik	Neni 111
	Informacioni dhe komunikimi	Neni 112
	Kërkimi shkencor dhe zhvillimi teknologjik	Neni 118
7. Transporti, Energjia, Mjedisi dhe Zhvillimi Rajonal	Transporti	Neni 113
	Energjia	Neni 114
	Mjedisi	Neni 115
	Ndryshimet klimatike	Neni 116
	Mbrojtja civile	Neni 117
	Zhvillimi rajonal dhe lokal	Neni 119

Struktura e Grupeve të veçanta

Titulli	Çështjet	Neni i Marrëveshjes
Grupi i veçantë për Reformën e Administratës Publike	Reforma e administratës publike	Neni 120
Grupi i veçantë për normalizim ¹	Përmirësimi i dukshëm dhe i qëndrueshëm i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, dhe bashkëpunimi efektiv me Misionin PPJS të BE-së CSDP për deri sa ekziston	Neni 5

¹Ky Grup i veçantë nuk zëvendëson dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit që realizohet nën udhëheqjen e Përfaqësuesit të Lartë.

SHTOJCA II

Termet e Referencës së Nënkomiteteve dhe Grupeve të veçanta BE-Kosovë*

Përbërja dhe Kryesuesi

Nënkomitetet dhe grupi i veçantë për reformën e administratës publike (RAP) dhe ai për normalizim përbëhen nga përfaqësues të Komisionit Evropian, Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, në rastin e grupit të veçantë për normalizim, dhe përfaqësuesve të Kosovës. Ato do të kryesohen me radhë nga të dyja palët. Shtetet Anëtare do të informohen dhe ftohen në takimet e nënkomiteteve dhe grupit të veçantë për RAP dhe atij për normalizim.

Sekretariati

Një zyrtar i Komisionit Evropian, apo i Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, në rastin e grupit të veçantë për normalizim, dhe një zyrtar i Kosovës, shërbejnë bashkërisht si sekretarë të secilit prej nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta.

Të gjitha komunikimet në lidhje me nënkomitetet dhe grupet e veçanta u dërgohen sekretarëve të nënkomiteteve dhe të grupeve të veçanta përkatëse.

Takimet

Nënkomitetet dhe grupet e veçanta mbledhen sipas rrethanave, me pajtimin e të dyja Palëve. Secilitakim i nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta mbahet në kohën dhe vendin e dakorduar nga të dyja Palët.

Me dakordimin e të dyja Palëve, Nënkomitetet dhe Grupet e veçanta mund të ftojnë ekspertë në takimet e tyre, me qëllim ofrimin e informatave specifike të kërkuara.

*Kyemërtimështë pa paragjykimndajqëndrimevepërstatusin, dheështënëpajtim me Rezolutën e KS tëOKB-së 1244/1999 dheOpinionin e GjND-sëmbishpalljen e pavarësisë sëKosovës.

Agjenda dhe dokumentacioni mbështetës

Kryesuesi dhe sekretarët hartojnë një agjendë të përkohshme për çdo takim jo më vonë se 30 ditë pune para fillimit të takimit.

Agjenda e përkohshme përfshin çështje në lidhje me të cilat kërkesa për përfshirje është pranuar nga sekretarët jo më vonë se 35 ditë pune para fillimit të takimit.

Pas dakordimit të agjendës së përkohshme për çdo takim dhe jo më vonë se 10 ditë pune para fillimit të takimit, sekretari në emër të Kosovës do t'ia dorëzojë sekretarit në emër të Komisionit Evropian, apo Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, në rastin e grupit të veçantë për normalizim, dokumentacionin e nevojshëm me shkrim, sipas renditjes së pikave të dakorduara në agjendën e përkohshme.

Nëse afati i përmendur në paragrafin e tretë nuk respektohet, takimi do të anulohet automatikisht pa njoftim shtesë.

Çështjet tematike

Nënkomitetet diskutojnë çështje që lidhen me fushat e Marrëveshjes të listuara në Strukturën shumëdisiplinare të nënkomiteteve. Progresi në lidhje me përafrimin, implementimin dhe zbatimin e legjislacionit do të vlerësohet në të gjitha çështjet tematike. Nënkomitetet shqyrtojnë çfarëdo problem që mund të del në sektorët përkatës dhe propozojnë ndërmarrjen e hapave të mundshëm. Nënkomitetet shërbejnë gjithashtu si forume për sqarimin e mëtejshëm të *acquis*-së dhe shqyrtojnë progresin e Kosovës në përafrimin me *acquis* në përputhje me zotimet e marra përsipër me Marrëveshje.

Grupi i veçantë për RAP diskuton çështje që lidhen me reformën e administratës publike dhe propozon hapat e mundshëm për t'u ndërmarrë. Grupi i veçantë për normalizim diskuton çështjet që lidhen me përmirësimin e dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, si dhe bashkëpunimin efektiv me misionin e PPSJ-së, deri sa të ekzistojë, dhe propozon hapat e mundshëm për t'u ndërmarrë.

Procesverbali

Procesverbalet mbahen dhe dakordohen pas çdo takimi. Një kopje e procesverbalit i përcillet Sekretarit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit nga sekretari i nënkomitetit, ose grupit të veçantë.

Publiciteti

Përveç nëse vendoset ndryshe, takimet e nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta nuk do të jenë publike.
